

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. <u>D.P</u> Dep. <u>D.P</u> Nr. l faq. Broj stranica Nr. pages	Nr. Prot. <u>03/3797/11</u> Br Prot. Prot No. <u>03/3797/11</u> Data Datum Date <u>29.09.2011</u> PRISHTINE



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË GJAKOVË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U ĐAKOVICI/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN GJAKOVË

Nr.regj.04-267/2010

GJYKATA KOMUNALE PER KUNDËRVAJTJE NE GJAKOVE, me Kryetaren Drita Bunjaku, duke vendosur ne proceduren kundervajtese kunder te pandehurit Shpejtim Hysen Skivjani nga Gjakova, per shkak vepre kundervajtje nga neni 16 par.1 te Ligjit peer deklarimin,perjardhjen dhe kontrollin e pasuris dhe te dhuratave te zyrtarve te larte publik, Nr.03/L-151 te Kosoves,e ne baze te nenit 73,74,109,123 dhe 199 te Ligjit mbi kundervajtjet, me 25.08.2011 merr kete:

A K T V E N D I M

I pandehuri Shpejtim Hysen Skivjani, me profesion menaxher I prokurimit, I lindur me 06.07.1965 ne Gjakove, Rr.Vashingtoni pn.

E S H T E P E R G J E G J E S

Per shkak se me 08.06.2010, i pandehuri Shpejtim si zyrtar i larte publik nuk ka deklarue gjendjen e pasuris se tij, ne Drejtorin e agjensionit kunder korrupcion qe ka qene i detyruar qe ta beje gjere me 31 Mars te qdo viti, dhe ta deklaroi pasurin e tij ne Agjensionin kunder korrupcion.

Me qka ka bere veper kundervajtese nga neni 16 par.1 te Ligjit peer deklarimin,perjardhjen dhe kontrollin e pasuris dhe te dhuratave te zyrtarve te larte publik, Nr.03/L-151 te Kosoves, andaj me aplikimin e dispozitave te permendura,

D E N O H E T

Me denim ne shume prej 300.-(Treqind).Euro.

I pandehuri eshte i obliguar qe denimin e shqiptuar te paguaj ne afatin prej 15 ditesh nga dita e plotefuqishmeris se ketij aktvendimi prane kesaj Gjykate, ne te kunderten denimi do te shenderohet me denim burgu ne kohezgjatje prej -20- ditesh,bazuar ne neni 5 te LMK.

Ne te njejtin afat i pandehuri eshte i obliguar qe ne emer te shpenzimeve procedurale te paguaj shumen paushalle prej -5-Euro, nen kercnim te permbarimit me dhune.

A r s y e t i m

Sipas kerkeses se Agjensia kunder korrupcionit ne Prishtine, nr. 01/2286/2010 dates 08.06.2010 kunder te pandehurit eshte fillue procedura kundervajtese prane kesaj Gjykate per shkak te kundervajtjes se pershkruar ne dispozitiv te ketij aktvendimi.

Ne procedurën kundervajtëse i pandehuri në deklaratën e dhënë pranë kësaj Gjykate, thotë se është e vërtetë se unë punoi si menaxher i zyrës së prokurimit në IMPK (Instituti i mjeksisë së punës Kosovë-Gjakovë) dhe lidhur me faktin se jemi të obliguar me e prezentuar formularin lidhur me pasurinë që ne disponoim nuk kam qenë në dijeni dhe formulari që gjendet në kërkesë nuk e kam marrë, tani po e shohë në dokumentacionin e lendeve. Nga një kolege në Prishtinë në një trajnim kam kuptuar se jemi të obliguar që të bëjmë plotësimin e një formulari lidhur me pronësinë e që ka të bëjë me njoftimin e Agjencionit kundër korrupsionit, e që unë nuk e kam ditur, ditën e fundit e kam bërë plotësimin e dokumentacionit dhe jam paraqitur në Agjencion mërejt një referent që ishte aty me ka thënë se paraqitjen e keni bërë mbas afatit, kështu që nuk më është pranuar. Ate kërkesë të pergaditur unë e kam në tavolinën e zyrës sime dhe të njëjten do të ju prezantoj.

Duke u bazuar në provat ekzistuese të parashtruara në lende nga Agjencia kundër korrupsionit në Prishtinë, deklarata e të pandehurit, Gjyqtarja konstatoi se në veprimin e tij ekzistojnë të gjitha elementet e kundervajtjes të pershkuara në dispozitiv të këtij aktvendimi për qka edhe u shpallë fajtor dhe u dënua në baze të Ligjit.

Me rastin e shqiptimit të dënimit Gjyqtarja ka marrë parasysh rendesin e veprës, pasojat e saj, rrethanat nën të cilat është kryer vepra kundervajtëse, shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit dhe gjendjen ekonomike të tij dhe të gjitha këto me bindje se me dënimin e dhënë do të arrihet qellimi i ndeshkimit.

Per sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës kanë të drejtë ankese në afat në brenda 8 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktvendimi Gjykates së Lartë për kundervajtje në Prishtinë.

Ankesa dërgohet nëpërmjet të kësaj Gjykate.

Aktvendimi i dërgohet të pandehurit dhe parashtruesit të kërkesës.

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË GJAKOVË.

Vendosur më 25.08.2011.

Nr.regj.04-267/2010.

